

**UNIVERSITETI I GJAKOVËS “FEHMI AGANI”**

**FAKULTETI I MJEKËSISË**

**DEGA : INFERMIERI**



**PUNIM DIPLOME**

**TEMA: HEMORAGJIA NË TRAKTIN DIGJESTIV**

**Kandidat-i/ja:**

Sevdije Idrizi

**Mentori:**

Dr.Mr.Sci. Skender Ukaj

**Gjakovë, 2018**

Punimi i temës së diplomës: **“HEMORAGJIA NË TRAKTIN DIGJESTIV”**, të:  
kandidatës **Sevdije Idrizi**, u punua në Fakultetin e Mjekësisë të Universitetit “Fehmi Agani”  
Gjakovë.

**Mentori i punimit:**

**Prof. Dr. Skender Ukaj**

Profesor i Fakultetit të Mjekësisë i Universitetit “Fehmi Agani” Gjakovë

**Punimi përmban:** 44 Faqe, 6 Figura dhe 1 Tabelë.

## **Deklaratë studentore**

*Unë Sevdije Idrizi, studente e Fakultetit të Mjekësisë në Universitetin e Gjakovës “Fehmi Agani”, deklaroj se kjo Temë e Diplomës “HEMORAGJIA NË TRAKTIN DIGJESTIV”, është punimi im origjinal. E gjithë literatura dhe burimet tjera që i kam shfrytëzuar gjatë punimit janë të listuara në referenca dhe plotësisht të cituara.*

## **Falenderimet**

Po e filloj këtë punim, duke e falenderuar Zotin që më ka mundësuar të vijë deri në këtë pikë të studimeve të mia, dhe të punojë këtë punim diplome, ku edhe shënoj përfundimin e studimeve bachelor në drejtimin e infermierisë pranë Universitetit të Gjakovës, duke shpresuar edhe në avansimet e mëturjeshe falë ndihmës së Zotit.

Falënderoj stafin drejtues të Universitetit për kushtët dhe mundësitë që më kanë ofruar gjatë ciklit të studimeve për realizimin sa më të lehtë të synimit tim dhe përmbushjes së objektivave drejt një suksesi në profesionin që e kam zgjedhur, e posaçërisht punën e palodhshme dhe plot lavdata të Departamentit të Infermierisë.

Gjithashtu falënderoj edhe profesorin udhëheqës, për ndihmën e ofruar për realizimin e këtij punimi të diplomës, ku pa ndihmën e profesorit të nderuar Skender Ukaj sigurisht ky punim do t'i kishte mangësitë e veta.

Pastaj, falënderoj familjën time për përkrahjen maksimale gjatë gjithë jetës sime, dhe posaçërisht për përkrahjen gjatë këtyre viteve të studimeve, ku pa përkrahjen e tyre dhe normalisht edhe të Zotit nuk do të mundë të arrija deri në këtë moment madhështor të jetës sime.

# PËRMBAJTJA

Abstrakti .....	7
Qëllimi i punimit .....	8
Metodologjia .....	8
1. Hyrje .....	9
2. Anatomia e traktit digjestiv .....	10
3. Hemoragjia në traktin digjestiv .....	14
3.1. Epidemiologjia .....	15
3.2. Patofiziologjia.....	16
3.3. Pasqyra klinike .....	18
3.4. Burimet e hemorragjisë së traktit gastroindestinal .....	19
3.4.1. Burimet e sipërme të hemorragjisë gastroindestinale .....	19
3.4.2. Burimet e hemorragjisë në zorrën e hollë .....	19
3.4.3. Burimet e hemorragjis në kollon.....	19
3.5. Shkaqet kryesore të hemorragjisë në traktin digjestiv .....	20
3.6. Hemoragjia në gojë.....	21
3.7. Hemoragjia në ezofag .....	22
3.8. Hemoragjia në lukth .....	24
3.9. Hemoragjia në zorren e hollë.....	26
3.10. Hemoragjia në zorren e trashë dhe rektum.....	27
3.11. Komplikacionet.....	29
3.12. Faktorët e rrisht të hemorragjis në traktin digjestiv .....	29
3.13. Shenjat e hemorragjis të traktit digjestiv të sipërm dhe të poshtem.....	30
3.14. Shenjat e hemorragjisë akute dhe kronike .....	31

3.15. Si dallohet hemoragjia në traktin digjektiv.....	32
3.16. Si të dalloni gjakun në feçe dhe të vjella.....	32
3.17. Qasja ndaj të sëmuarve me hemoragji nga trakti digjektiv.....	33
3.18. Diagnostikimi .....	34
3.19. Trajtimi.....	37
3.20. Kujdesi infermieror.....	39
4. Rekomandimet .....	41
5. Përfundimi .....	42
6. Referencat.....	43
7. CV e kandidatës.....	44

## **Abstrakt**

Ky punim diplome u realizua me qëllim që të shpjegohen dhe zgjërohen njohuritë lidhur me Hemoragjinë në traktin digjektiv. Epidemiologjinë e hemoragjisë digjestrive patofiziologjinë, pasqyrën klinike, shkaktarët më të shpeshtë të hemoragjisë digjestrive. Shkaqet që e shkaktojnë hemoragjinë në gojë dhe trajtimi i tyre hemoragjia në ezofag, lukth, zorrë si dhe trajtimi i tyre komplikacionet e hemoragjisë digjestrive simptomat, faktorët e rrisht, shënjat e hemoragjisë digjestrive diagnostikimi dhe trajtimi. Metodologjia e përdorur për realizimin e këtij punimi është rishikim literature. Ky punim është i rëndësishëm, sepse jep informata për sëmundjet të cilat e shkaktojnë hemoragjinë në traktin digjektiv e sidomos për rolin që ka infermieri/infermierja në trajtimin e kësaj sëmundjeje dhe kujdesin ndaj pacientit.

## **Metodologjia**

Për realizimin e këtij punimi është përdorur metoda e rishikimit të literaturës, në këtë punim kemi paraqitur informacione mbi Hemoragjinë në traktin digjektiv.

## **Qëllimi i punimit:**

Qëllimi i këtij punimi është të zgjerojmë njohuritë lidhur me hemoragjitë në traktin digjektiv. Si dhe të evitohen shkaqet e hemoragjive digjестive, ku rëndësia e këtij punimi lidhet me konstatimin e patologjive madhore që shoqërohen me hemoragji digjестive dhe trajtimin e mëvonshëm të tyre.



# 1. Hyrje

Hemoragjia në traktin tretës është një shenjë sëmundjeje dhe jo sëmundja vetë. Hemoragjia ndodh nga një sërë faktorësh, disa prej të cilëve janë kërcënues për jetën. Shumë arsye të hemoragjisë janë të kurueshme dhe të kontrollueshme, si për shembull ulçerat apo hemorroidet.

Shkaku i hemoragjisë mund të mos jetë serioz, por lokalizimi i burimit të saj është i rëndësishëm. Trakti tretës përfshinë gojën, ezofagun, stomakun, zorrën e hollë, zorrën e trashë, rektumin dhe anusin.

Hemoragjia mund të ndodhë në një prej këtyre pjesëve, nga zona të vogla siç janë ulçerat e stomakut ose nga hapësira të mëdha siç është inflamacioni i mukozës së kolonit (zorrës së trashë). Ndonjëherë hemoragjia ndodh pa u vënë re nga personat. Kjo lloj hemoragjie quhet okulte ose e fshehur. Fatmirësisht, një analizë e thjeshtë feçe gjaku okult mund të vërtetojë praninë e saj.<sup>1</sup>

---

<sup>1</sup> <http://www.altincekodhima.com/?go=hemoragjia>.

## 2. Anatomia e sistemit digjestiv

Që ta kuptojmë më mirë origjinën e hemoragjisë në traktin tretës apo digjestiv atëherë po japim disa të dhëna për traktin digjestiv.

Ushqimin që e marrim, në pikëpamje fizike dhe kimike është i ndryshëm. Që të mund të shfrytëzohet, duhet t'i nënshtrohet ndryshimeve fiziko-kimike.

Këto funksione të ndërlikuara kryhen në sistemin e organeve tretëse. Përveq rolit tretës, këto organe kanë për detyrë absorbimin e ushqimit të tretur dhe nxjerrjen jashtë të materieve të patretura.

Trakti digjestiv fillon me hapsirën e gojës dhe vazhdon me gypin tretës dhe në fund përfundon me anus.




Fig: 1 Organet që e përbëjnë sistemin digjestiv.

Burimi: <https://www.google.com/search?q=anatomia+e+sistemit+tretes>

**Sistemi tretës është i përbërë nga këto organe:**

- Zgavra e gojës ( *cavum oris* ),
- Fyti ( *pharynx* ),
- Kapërçelli ( *oesophagus* ),
- Lukthi apo stomaku ( *gaster-ventriculus* ),
- Zorra e hollë ( *intestinum tenue* ),
- Zorra e trashë ( *intestinum crassum* ),

Tretjes i ndihmojnë edhe lëngjet e gjëndrrave pështimore, mëlçia dhe pankreasi si dhe fshikëza e tëmthit.<sup>2</sup>




Fig: 2 Sistemi digjestiv dhe gjëndrrat ndihmese të tretjes.

Burimi: <https://www.google.com/search?q=anatomia+e+sistemit+tretes>

<sup>2</sup> Anatomia dhe fiziologjia e njeriut për kl.e I të shkollave të mesme të mjeksisë prishtine 2001 prof.Eshref Saraqini- Dr.Hariet Zherka-Saraqini.113-119

## Trakti i tretjes është i ndarë në dy pjesë

Trakti i sipërmë i tretjes përfshinë:

- Zgavren e gojës
- Ezofagun
- Lukthin
- Pjesen e sipërme të zorrëve të holla

Trakti i poshtëm i tretjes përfshinë:

- Pjesën më të ulët të zorrëve të holla
- Zorren e trashë
- Anusin.<sup>3</sup>

- **Zgavra e gojës:** kjo përfaqëson zgavrën që fillon me vrimën e gojës, që përpara kufizohet me buzët kurse prapa me hyrjen në laring.
- **Gjuha:** më pjesën e prapme të saj është e fiksuar për dyshemenë e zgavrës së gojës. Mukoza, më të cilën është e mbuluar, është e trashë, e vrazhdë, për shkak të shumë puqërrzave-papilave. Papilat kanë formë e funksione të ndryshme, janë struktura shqisore për pranimin e ngacmimeve të shijës, prekjes, temperatures dhe dhëmbjes.
- **Dhëmbët:** janë organe eshtërore të ngulur në nofulla. Ndahen në dhëmbet qumështorë dhe të përhershëm. Dhëmbët qumështorë (20) paraqiten në intervalin prej 6-12 muaj kurse rreth vitit 6-18 ndërrohen me ata të përhershmit që janë 32.
- **Fyti:** është pjesë e traktit digjestiv që ndodhet para shtyllës vërtebrore, komunikon me zgavren e hundës, të gojës dhe të laringut. Shtrihet nga baza e kafkës deri të vërtebra e VI qafore ku vazhdon në ezofag.
- **Kapërçelli-ezofagu:** është gyp muskolor, që lidh fytin me lukth.

---

<sup>3</sup> Ana Xhakollari “Hemoragjia e brëndëshme Gastroindestinale, diagnostifikimi, trajtimi dhe kujdesi infermieror” Durrës 2014.

- **Lukthi :** është pjesa më e gjërë e sistemit tretës. Ka formën e një strajce (25cm), gjendet në pjesën e sipërme të zgavrës barkore, nën diafragmë.
- **Zorra e hollë :** është gyp muskulo-mukoz e gjatë 5-7m, i cili përcjellë ushqimin nga lukthi deri në pjesën fillestare të zorrës së trashë. Këtu përfundon tretja e ushqimit, kryhet resorbimi dhe pjesët e patretura hudhën në zorrën e trashë.
- **Zorra e trashë:** është pjesa përfundimtare e kanalit tretës, e gjatë rreth 1.5 m. Kjo,nga zorra e hollë pranon qullin, ia merr këtij lëngun e tepërtë dhe e shëndrron në fekalie (feçes).
- **Gjëndrrat pështymore:** këto janë gjëndrra të cilat ekskretin e tyre, pështymen e derdhin në gojë. Ekzistojnë 3 palë gjëndrra nëngjuhore pështymore.
- **Pankreasi:** është gjëndërr që ndodhet prapa lukthit mbi murin e prapmë të barkut, në nivelin e vërtebrës së I të belit. Është gjëndërr me sekrecion të jashtëm (*ekzokrin*) dhe të brendshëm (*endokrin*).
- **Mëlçia :** Mëlçia është organi më i madh parenkimatoz në trupin tonë, peshon rreth 1.5 kg gjendet nën gjysmën e djathtë të diafragmës.<sup>4</sup>

---

<sup>4</sup>Anatomia dhe fiziologjia e njeriut për kl.e I të shkollave të mesme të mjeksisë prishtine 2001 prof.Eshref Saraqini-Dr.Hariet Zherka-Saraqini.113-119.

### 3. Hemoragjia në traktin digjestiv

Gjakderdhje GI (Gastroindestinale) është shfaqja e gjakut në traktin digjestiv. Karakterizohet me vjellje të gjakut, gjakderdhje rektale, jashëqitje të zezë katran apo gjakderdhje okulte kronike. Manifestimet klinike të gjakderdhjeve digjestive varen nga vendi i gjakderdhjes, sasia e gjakderdhjes dhe prania e sëmundjeve tjera.

Me gjakderdhje digjestive pra nënkuptojmë çdo gjakderdhje në lumenin e traktit digjestiv apo tretës. Shkaktarët e gjakderdhjes mund të jenë lokal dhe të përgjithshme (hemophilia, leukemia, trombocitopenia etj).<sup>5</sup>

*Sipas lokalizimit dallojmë dy grupe të mëdha të gjakderdhjes nga trakti digjestiv:*

- a) Gjakderdhjet nga pjesa e sipërme të traktit digjestiv proksimalisht nga ligamenti i Treitz-it që fillon nga goja, ezofagu, stomaku dhe duodeni.
- b) Gjakderdhjet nga pjesa e poshtme e traktit digjestiv, distalisht nga ligamenti i Treitz-it me origjinë nga zorra e trashë, rektumi dhe anusi<sup>6</sup>

*Kurse në bazë të humbjes së gjakut kemi:*

Bazuar në evolucionin e saj, kjo humbje mund të jetë akute ose kronike, varësisht nga vëllimi i humbur i gjakut dhe koha që ka humbur

- Një vëllim i madh i humbur në një kohë të shkurtër është një hemoragji **Akute**. Pra hemoragjia e papritur dhe e rëndë quhet hemoragji akute.
- Ndërsa humbjet e ngadalta në një kohë më të gjatë përbëjnë një hemoragji **Kronike**. Pra hemoragjia e butë që vazhdon për një kohë të gjatë, ose fillon dhe ndalet quhet hemoragji kronike.

---

<sup>5</sup> Prof.Dr.Bozhidan Vrhovac “Mjekësi Interne – Gastroenterologjia.”

<sup>6</sup> Ivan Prpic “Kirurgjia“ për studentët e mjekësisë.

### 3.1. Epidemiologjia

Ka raste të hemoragjive gastroindestinale që nuk janë pasqyruar kurr në literaturën mjeksore. Padyshim ka raste kur individet kanë hemorroide të jashtme ose një episod të vetëm të hematemezës që nuk kërkojnë kurr kujdes mjeksore. Është vënë re se hemoragjia në traktin digjestiv ndodh më shpesh në traktin e sipërm digjestiv si (gojë, ezofag, lukth dhe në pjesën proksimale të duodenit ) që zënë 85-90% të rasteve.

Trakti i poshtëm gastroindestinal që përbëhet nga zorra e trashë, rektumi dhe anusi zënë 10-15% te rasteve.

Incidenca e hemoragjisë së sipërme gastroindestinale varion nga 50-170 raste për 100.000 banorë në vit. Në përgjithsi incidenca e hemoragjisë gastroindestinale rritet me moshën zakonisht mbi 60 vjeçë dhe për gjininë mashkullore.

Vdekshmëria nga hemoragjia e traktit digjestiv është e lidhur drejtpërdrejtë me moshën dhe sëmundjet bashkëshoqëruese të gjakderdhjes.

Disa studime raportojnë se vetem 1/3 e vdekshmerisë nga hemoragjia në traktin digjestiv lidhet drejtpërdrejtë me gjakderdhjen ndërsa 2/3 e pacientëve mendohet që të vdesin nga shkaqe të tjera. Shkaqe të tjera përfshijnë sëmundjet malinje, ciroza dhe sëmundjet kronike të frymëmarrjes që janë faktorë me prognozë të keqe.<sup>7</sup>

---

<sup>7</sup> Ana Xhakollari “Hemoragjia e brëndëshme Gastroindestinale, diagnostifikimi, trajtimi dhe kujdesi infermieror” Durrës 2014.

## 3.2. Patofiziologjia

Organizmi njerzor mund ti përshtatet humbjes graduale të gjakut pa ndonjë çrregullim domethënës të funksioneve përmes aktivizimit të mekanizmave homeostatik, të cilët përfshijnë rritjen e aktiviteteve neurovegjetative, lirimin e katekolaminave, hormonit adrenokortikotrop (ACTH), hormonit antidiuretik (ADH), aldosteronit, glukokortikoideve dhe prostaglandineve. Më me rëndësi është shpejtësia e humbjes së gjakut se sa vëllimi i gjakut të humbur. Humbja e lehtë e gjakut në sasi 10-15% të vëllimit intravaskular aktivizon mekanizmat homeostatik. Kontraksioni i sistemit venoz bën rishpërndarjen e gjakut nga bazeni venoz për të mbajtur vëllimin cirkulator, që është me e rëndësishme se sa masa aktuale e eritrociteve.

Tek gjakderdhjet profuze, kur mekanizmi hemostatik dështon, i sëmuri mund të bjerë në gjendje shoku kur humb vetëm 10% të vëllimit të gjakut sepse shfaqen ndryshime në vëllimin minutor dhe shtypjen e gjakut.

Te gjakderdhjet e rënda, me humbjen e më shumë se 15% të vëllimit të gjakut, vjen deri të dështimi i mekanizmave kompensatorë. Mund të shfaqet sinkopa, marramendja, mundimi, djersitje dhe etje.

Mbajtja e vëllimit minutor arrihet përmes rritjes së frekuencës dhe forcës së kontraksionit të zemrës, vazokonstruksionit periferik dhe rritjes së sekretimit të aldosteronit dhe hormonit antidiuretik (ADH).

Me shfaqjen e acidozës paraqitet edhe shoku. Të gjakderdhjet më të rënda me humbje të më shumë se 30% të vëllimit të gjakut, gjithmonë shfaqet hipotensioni për shkak të rënjes së madhe të vëllimit minutor, prandaj edhe kemi shfaqje të dëmtimit të rëndë multiorganik-insuficiencë akute të veshkave, dëmtim të mëlçisë, rënja e përfuzionit koronar shpejtë shkakton ishkemi të miokardit.

Sa i përket hematokritit (hct), deri të rënia e tij nuk vjen në të njëjtën kohë me paraqitjen e gjakderdhjës, për shkak të humbjes proporcionale të plazmës dhe eritrociteve.



Në momentin kur lëngjet ekstravaskulare kalojnë në hapësirën intravaskulare, atëherë fillon të bie vlera e hematokritit (Hct-së).

Për këtë arsye peshën e gjakderdhjes nuk mund ta vlerësojmë ne bazë të vlerave të hematokritit menjëherë pas gjakderdhjes, por pas disa orësh ose ditësh.<sup>8</sup>

---

<sup>8</sup> Prof.Dr.Bozhidan Vrhovac “Mjekësi Interne – Gastroenterologjia”

### 3.3. Pasqyra klinike

Simptomat dhe shenjat e gjakderdhjes së traktit digjestiv varen nga vëllimi i gjakut të humbur, si dhe janë shprehje e të gjitha ngjarjeve të përshkruara në kuadër të fispatologjisë.

Shtypja e gjakut dhe frekuenca e zemrës janë shprehje e shpejtësisë së humbjes së gjakut. Në fillim, shenjë e vetme fizike mund të jetë hipotensioni postural. Tek humbjet e mëdha të gjakut tahikardia dhe vazokonstriksioni tentojnë të mbajnë vëllimin qarkullues, por se hipotensioni është prezent edhe në pozitë të shtrirë.

Hemoragjitë nga trakti tretës ndahen në hemoragjit nga pjesa e sipërme (goja, ezofagu, lukthi dhe zorra dymbëdhjetëgjishtore ose (duodeni) ~80% ) dhe hemoragjia nga pjesa e poshtme e traktit tretës (zorra e hollë jejunum dhe ileum~2%) dhe zorra e trashë (koloni dhe rektumi~18%).

**Hematemeza:** Nënkupton vjellje të përmbajtjes me gjak të freskët ose me ngjyrë kafe të mbyllët dhe flet për gjakderdhje nga pjesa e sipërme e traktit tretës. Gjaku i vjellur mund të jetë i freskët, me ngjyrë të kuqe ose i mbyllët, me ngjyrë të kafes së zezë.

**Melena:** Është feçes (jashtëqitje) me ngjyrë të zezë si katrani dhe nënkupton gjakderdhjen nga pjesa e sipërme e traktit tretës. Ngjyra si katran vjen për shkak të zbërthimit të hemoglobinës në traktin tretës në hematin nën ndikimin e lëngut të lukthit e cila i jep ngjyrën e zezë feçesit.( Duhet dalluar ngjyrën si katran të feçesit te melena prej ngjyrës së zezë të feçesit pas marrjes së preparateve të hekurit, bismuthit apo ngrënies së boronicave.)

**Hematokezia:** Është paraqitja e gjakut të kuqë të qelur ose të mbyllët në rektum dhe është shenjë e gjakderdhjes nga pjesa e poshtme e traktit tretës.

**Gjakderdhja okulte:** Mund të jetë kronike ose akute e ngadaltë. Në këtë rast, humbja e gjakut nuk vërehet, mirëpo vërtetohet përmes testimeve të veçanta të mostrave të fecesit (hemokult testi apo gvajakol prova). Kjo formë e gjakderdhjes mund të paraqitet në cilën do pjesë të traktit tretës. I sëmuri në këtë rast nuk ka shenja objektive (të dukshme) të humbjes së gjakut, por vetëm simptoma të humbjes së tij. Lëkura dhe mukozat e dukshme janë të zbehta. Gjithashtu lajmërohet edhe sinkopa, dispnea, stenokardia dhe shoku.

## **3.4. Burimet e hemoragjisë së traktit gastroindestinal**

### **3.4.1. Burimet e sipërme të hemoragjisë gastroindestinale**

Ulçerat peptike janë shkaktarët më të zakonshëm të shfaqjes së rasteve me hemoragji në pjesën e sipërme të traktit tretës duke zënë deri në ~ 50% të tyre; një numër gjithnjë e më i madh vjen si pasojë e përdorimit të terapive mjekuese me medikamente antiinflamatore josteroide (NSAID) me reduktim të prevalencës së pranisë së *Helicobacter pylori*. Lacerimet e sindromës Mallory-Weiss zënë ~5-10% ose 15% të rasteve në fjalë. Raporti i pacientëve me hemoragji të shkaktuar nga prania e variçeve varion mjaft nga ~5 deri në 30%, në varësi të popullatës.

Gastropatia hemoragjike ose erozive (p.sh., e shfaqur si pasojë e përdorimit të NSAID-ve apo konsumimit të alkoolit) dhe ezofagiti eroziv shpeshherë janë të aftë të shkaktojnë shfaqjen e formës së lehtë të hemoragjisë së sipërme të traktit digjektiv.

### **3.4.2. Burimet e hemoragjis në zorrën e hollë**

Shkaktarët më të zakonshëm përbëhen nga ektazitë dhe proceset tumorale vaskulare. Përdorimi i NSAID-ve indukon shfaqjen e proceseve erozive në zorrën e hollë dhe ulçerave dhe mund të jetë një shkaktar i zakonshëm relativ i formës kronike të hemoragjis së sipërme të traktit tretës së paqartë.

### **3.4.3. Burimet e hemoragjis në kolon**

Hemorroidet janë ndoshta shkaktarët më të zakonshëm të shfaqjes së hemoragjisë nga pjesa e poshtme e traktit digjektiv, fisulat anale janë të afta gjithashtu të shkaktojnë hemoragji në sasi të vogla.<sup>9</sup>

---

<sup>9</sup> “Parimet e Mjekësisë interne” Fauci, Braunwald, Kasper, Huser, Lomgo, Jameson. Harrison faqe 257 -258

### **3.5. Shkaqet kryesore të hemoragjisë në traktin digjektiv**

**Cilat janë shkaqet kryesore që shkaktojnë hemoragjinë digjektivë ?**

#### **Gojë:**

- Gingivitis (inflamacion i mishit të dhëmbëve).
- Mungesa e vitaminave C dhe K
- Kanceri oral

#### **Ezofag**

- Inflamacioni, (ezofagiti).
- Vena të zgjeruara (variçet)
- Gërvishjet, (Mallory- Weiss sindrom)
- Sëmundje të mëlçisë

#### **Lukth**

- Ulçerat
- Gastritet
- Kanceri

#### **Zorra e hollë**

- Ulçerat duodenale
- Inflamacioni (sindromi i zorrës së irrituar)
- Kanceri

#### **Zorra e trashë dhe rektum**

- Hemorroidet
- Infeksioni
- Inflamacioni (koliti ulçeroz)
- Polipet kolorektale
- Sëmundja divertikulare.

### 3.6. Hemoragjia në gojë

**Gingivitis:** Është sëmundja e mishit të dhëmbëve apo inflamacioni i mishit të dhëmbëve që do të thotë që mishrat janë të përflakur, të kuq dhe që rrjedhin gjak lehtë kur preken si rezultat i krijimit të pllakave në dhëmbë një depozitë që përmban bakterie që ndërtohet deri në sipërfaqen e dhëmbëve. Dhe kur bakterjet e pllakave dhe sheqeri i ushqimeve kombinohen atëherë formohen acide të cilat shkatërrojnë zmallin e dhëmbëve dhe shkaktojnë gjakderdhjen e dhëmbëve apo gingivitis. Gingivitis është e rëndësishme që të merret seriozisht dhe të trajtohet menjëherë pasi që, gingivitis nëse nuk trajtohet me kohë mund të çojë në sëmundjen shumë më serioze të dhëmbëve të quajtur periodontiti. Sëmundja periodontale, ose periodontiti mund të shkaktojë që dhëmbët tuaj të treten ose të bien.

Shkaku më i zakonshëm i gingivitis është higjiena e dobët e gojës.

**Trajtimi:** Zakonet e mira të shëndetit oral, të tilla si pastrimi i të paktën dy herë në ditë, pastrimi i përditshëm dhe bërja e kontrolleve të rregullta dentare, mund të ndihmojnë në parandalimin dhe zhvillimin e kësaj sëmundje. Vizitoni dentistin dy herë në vit për një pastrim profesional. Dentisti juaj mund t'ju udhëzojë gjithashtu të përdorni një gargarë antiseptike për të minimizuar pllakën që formon në gojën tuaj. Një pije e ujit të kripur të ngrohtë mund të ndihmojë në zbutjen e mishrave të fryrë që rrjedhin lehtë. Përdorni një furçë dhëmbësh të butë që është e butë në mishrat e inflamuar sidomos nëse përjetoni gjakderdhje pas larjes së dhëmbëve.<sup>10</sup>

**Kanceri i gojës:** I referohet kancerit që zhvillohet në secilën nga pjesët që përbëjnë gojën. Kanceri i gojës bënë pjesë në kancerin e kokës dhe të qafës. Kanceri i gojës ndodh kur qelizat në buzë ose në gojë zhvillojnë ndryshime (mutacione) në ADN-në e tyre.

**Trajtimi:** Kanceri i gojës trajtohet në të njëjtën mënyrë si kanceret e tjera me kirurgji, rrezatim, dhe kimioterapi.<sup>11</sup>

---

<sup>10</sup> <https://www.mayoclinic.org/diseases-conditions/gingivitis/symptoms-causes>

<sup>11</sup> <https://www.mayoclinic.org/diseases-condition/mouth-cancer/diagnosis-treatment/>

### 3.7. Hemoragjia në ezofag

Hemoragjia ne ezofag ndodhë nga disa shkaktarë që i kemi cekur edhe me lart por shkaktarët më të shpeshtë të hemoragjisë janë:

**Variçet ezofageale** - ose (venat e fryera) variçet ezofageale janë zgjerim jo normal i venave në pjesën e poshtme të ezofagut). Variçet ezofageale ndodhin më shpesh tek personat që kanë sëmundje serioze të mëlçisë. Ato zhvillohen kur ngadalësohet qarkullimi normal i gjakut në mëlçi. Në këtë moment gjaku kthehet mbrapsht në enët e vogla të afërta, siç janë ato të ezofagut duke shkaktuar fryrje të tyre.

Ndonjëherë variçet ezofageale mund të çahen duke shkaktuar hemoragji kërcënuese për jetën.




Fig: 3. Variçet ezofageale

Burimi: <https://www.news-medical.net/health/Esophageal-Varices>

---

## Komplikacionet

Hemoragjia është i vetmi komplikim serioz i gjendjes. Në disa raste hemoragjia mund të jetë aq e madhe sa që pacienti mund të pësojë shok deri në vdekje.

**Trajtimi :** Qëllimi kryesor në trajtimin e variçeve ezofageale është parandalimi i hemoragjisë. Hemoragjia prej variçeve ezofageale është e rrezikshme për jetën.

- Medikamentet që përdoren për të ulur qarkullimin e gjakut në venën porta quhen beta bllokues siç është atenololi ose nadololi. Nëpërmjet këtyre medikamenteve ulet rreziku për hemorragji prej variçeve.
- Një mënyrë tjetër për të trajtuar variçet të cilat kanë tendencë të shkaktojnë hemorragji është përdorimi i gastroskopit nga doktori për të parandaluar hemorragjinë.<sup>12</sup>

**Ezofaiti:** Që është inflamacion i ezofagut të cilin e shkakton acidi i stomakut mund të shkaktojë inflamacion i cili mund të çojë në hemorragji në pjesën e poshtme të ezofagut. Zakonisht, kjo situatë shoqërohet me djegie kraharori dhe quhet ezofagitis ose inflamacion i ezofagut. Në shumë raste, muskujt ndërmjet fundit të ezofagut dhe fillimit të stomakut nuk realizojnë mbylljen plotësisht të sfinkterit i cili në këtë rast lejon kthimin e lëngjeve acide të stomakut në ezofag dhe si rrjedhojë ndodh inflamacioni. Shkaqet e ezofagitisit përfshijnë acidet e stomakut që mbështeten në ezofag, infeksion, medikamente orale dhe alergji.

**Trajtimet :** Për ezofagitin synojnë të zvogëlojnë simptomat, të menaxhojnë komplikimet dhe të trajtojnë shkaqet themelore të çrregullimit. Strategjitë e trajtimit ndryshojnë kryesisht bazuar në shkakun e çrregullimit.<sup>13</sup>

---

<sup>12</sup> <http://www.altincekodhima.com/?go=varice>

<sup>13</sup> <https://www.mayoclinic.org/diseases-conditions/esophagitis/diagnosis-treatment>

### 3.8. Hemoragjia në lukth

**Gastriti:** Është një inflamacion i mukozave të stomakut. Gastritis klasifikohet si akut dhe kronik. Klasifikimi i gastriteve ka të bëjë me tipin e inflamacionit dhe jo me kohën në të cilën ato zhvillohen. Incidenca e gastritit është më e lartë tek burrat se tek gratë, më e lartë tek njerëzit me moshë 40-50 vjeç, dhe paraqitet më e rëndë tek pirësit e duhanit dhe alkoolit.

Trajtimi i tij zakonisht bëhet më antibiotik dhe antiacidet.

**Sëmundja ulçeroze është shkaktari më i shpeshtë i gjakderdhjes prej pjesës së sipërme të traktit tretës është gjakderdhja prej ulçerës gastrike dhe duodenale.**

**Ulçera peptike:** Ndodh në stomak, kryesisht në duoden dhe më rrallë në ezofagun e poshtëm. Ulçera peptike është një dëmtim i vazhdueshëm i mukozave. Mund të ndodh në çdo pjesë të traktit gastrointestinal që është në kontakt me acidin klorhidrik dhe pepsinën.

Komplikacionet më të shpeshta të ulçerës peptike janë: hemoragjia, perforacioni, obstruksioni i pilorit(blokimi i pilorit) dhe kriza ulçerike.


Tipet e ulçerës peptike janë: ulçera gastrike , duodenale dhe ulçera stresante

**Ulçera gastrike:** Është një dëmtim në mukozat gastrike që përhapen në mukozat muskulare. Gjenden zakonisht në bashkimin e bazës dhe pilorit, por ulçerat e vogla mund të zhvillohen në antrum. Më shumë ulçerat gastrike zhvillohen në kurvaturën e vogël pranë pilorit.

Ulçera gastrike ndodh zakonisht në moshat 40 dhe 50 vjeçare.

Ka një sërë faktorësh që e shkaktojnë ulçerën gastrike si aspirina, ibuprofeni ose medikamente të tjera anti-inflamatore, duhani, alkooli dhe stresi, teofilina dhe kafeina. Ndonjëherë shumë acid prodhohet nga stomaku si pasojë e tretjes. Shumë kërkime kanë treguar se shumë njerëz me ulçer kanë një infeksion në stomak nga një bakterie e quajtur **Helikobakter pylori** që është shumë e rëndësishme në zhvillimin e ulçerave.





Burimi : <https://www.google.com/search?q=ulcera+gastrike>

Fig: 4. Ulçera në lukth, ulçera gastrike.

**Trajtimi** : Objektivi kryesor i terapisë medikamentoze në trajtimin e ulçerës peptike është të sigurojë një pushim (qetësi) për stomakun.

Qëllimi i terapisë përfshin: reduktimin e sekrecioneve (medikamente hiposekretuese) neutralizim të acidit (antiacid) apo frenuesit e pompes protonike si pantoprazol, omeprazol etj. Mbrojtjen e mukozave mbrojtëse nga ulja e aktiviteteve të pepsinës dhe acidit hidroklorik. Si dhe antagonistët e receptorëve H2 si cimetidina dhe ranitidina. Dhe të sëmundjet e ulçerës si pasojë e helikobakter pylori përdoren edhe antibiotik.<sup>14</sup>

<sup>14</sup> Peka E, Neçaj L, Rustami E, Bego D, Lelçaj A, Çela M, Dervishi A, Zanaj V, Mane V Universiteti i Tiranës Fakulteti I Infermierisë Infermieristika në specialitete Tiranë 2005: 75-79.

### 3.9. Hemoragjia në zorrën e hollë

**Ulçera duodenale:** Është një dëmtim kronik në mukozat duodenale që depërton në mukozat muskulare. Ulçerat duodenale që zhvillohen në duoden, janë tipet më të shpeshta të ulçerës peptike. Faktorët që e shkaktojnë janë po thuaj të njëjtit që e shkaktojnë edhe ulçerën gastrike si dhe edhe terapia për mjekimin është e njëjtë. Ulçerat duodenale janë më të shpeshta në burra në moshë 30 dhe 40 vjeç.<sup>15</sup>

Burimi: <https://www.google.com/>




Fig : 5. Ulçera duodenale në zorrën e hollë

---

<sup>15</sup> Peka E, Neçaj L, Rustami E, Bego D, Lelçaj A, Çela M, Dervishi A, Zanaç V, Mane V Universiteti i Tiranës Fakulteti I Infermierisë Infermieristika në specialitete Tiranë 2005: 75-79.


### 3.10. Hemoragjia në zorrën e trashë dhe rektum

**Hemoroidet:** Termi hemoroide i referohet një situate në të cilën venat përreth anusit ose të pjesës së poshtme të rektumit janë të fryra dhe të skuqura si dhe të zgjeruara. Hemoroidet mund të jenë shkak i shtërzimeve për të defektuar.

Faktorë të tjerë që luajnë rol në formimin e tyre janë: shtatëznia, plakja, konstipacioni (kapsllëku) kronik ose diarreja (barkqitja) kronike. Hemoroidet janë ose brenda anusit (interne) ose jashtë lëkurës përreth anusit (externe).

Hemoroidet janë shumë të shpeshta si te burrat dhe te gratë. Rreth gjysma e popullsisë kanë hemoroide rreth moshës 50 vjeç. Pak më shpesh lajmërohen tek femrat.

Po ashtu hemoroidet mund të jenë të shpeshta dhe tek gratë shtatzëna, situatë e cila shpjegohet me presionin që fetusi shkakton në bark gjithashtu ndryshimet hormonale shkaktojnë zgjerim të venave hemoroidale. Gjithsesi hemoroidet gjatë shtatëzansë janë probleme kalimtare.



## **Si parandalohet formimi i hemoroideve dhe trajtimi i tyre**

**Trajtimi medikamentoz i hemoroideve:** ka për qëllim të lehtësojë simptomat, por të rëndësishme janë masat parandaluese për formimin e tyre. Parandalimi i përsëritjeve të hemoroideve do të kërkojë jashtëqitjen normale (pa kapsllëk) e cila arrihet me një diete të pasur me fibra dhe lëngje.

Me anë të kësaj diete arrihet që materialet fekale të jenë të buta dhe lehtësisht të lëvizshme nëpër zorrë duke mënjanuar shtërzimet në defektim dhe uljen e presionit të venave të anusit. Duke ngrënë sasinë e duhur me fibra ushqimore dhe pirja e 6 deri në 8 gota lëngjesh ( pa alkool) rezultojnë në jashtëqitje të butë e të formuar, e cila bën të lehtë zbrazjen e zorrës. Fibrat ushqimore merrën nëpërmjet konsumit të frutave, perimeve dhe miellit me përmbajtje krundesh.

Mjeku mund t'ju rekomandojë të merrni edhe fibra suplementare, produkte farmaceutike. Aktiviteti fizik ku përfshihet edhe e ecura dhe rritja e sasive të fibrave dhe lëngjeve në diete janë një kombinim i duhur për parandalimin dhe mos përsëritjen e hemoroideve.<sup>16</sup>

**Kanceri i kolonit dhe rektumit apo kanceri kolorektal:** Sipas shpeshtësisë së paraqitjes së kancerit kanceri kolorektal zënë vendin e dytë midis kancerëve në vendet e zhvilluara, kurse në të njëjtën kohë është edhe njëri ndër shkaktarët më të shpeshtë të vdekjeve në Europë dhe në SHBA.

Kanceri kolorektal është sëmundje e moshave të vjetra, por mund të paraqitet edhe në moshë të re. Shkaktari nuk është i njohur për kancerin kororektal por janë disa faktor të njohur të rrezikut si : ushqimi, trashëgimia, sëmundjet inflamatore të zorrëve etj.<sup>17</sup>

---

<sup>16</sup> <http://mjeksiaislame.com/hemorroidet/>

<sup>17</sup> Ivan Prpic “Kirurgjia“ për studentët e mjekësisë.

### **3.11. Komplikacionet**

Komplikacionet e mundëshme të hemoragjisë së traktit tretës:

- Anemi
- Dehidratim
- Dhimbje gjoksi - në qoftë se ka sëmundje të zemrës
- Përhapja e infeksionit
- Shok
- Vdekje

Sepse hemoragjitë e traktit digjektiv mund të jenë për shkak të sëmundjeve të rënda, dështimi për të kërkuar trajtim mund të rezultojë në komplikacione të rënda dhe dëmtim të përhershëm. Pasi shkaku themelor është diagnostikuar, është e rëndësishme të ndjekin planin e trajtimit të kujdesit shëndetësor për të zvogëluar rrezikun e komplikimeve të mundëshme.

### **3.12. Faktorët e rrishtit të hemoragjis në traktin digjektiv**

1. Përdorimi i alkoolit
2. Pirja e duhanit
3. Përdorimi për një kohë të gjatë të kontraktivëve
4. Përdorimi i antikoagulantëve
5. Përdorimi i antiinflatoreve josteroid ose aspirinës
6. Ulçera gastrike
7. Kirurgjia vaskulare
8. Ciroza hepatike
9. Historia e infeksioneve bakteriale, të tilla si Helikobakter pylori.<sup>18</sup>

---

<sup>18</sup> Ana Xhakollari “Hemoragjia e brëndëshme Gastroindestinale, diagnostifikimi, trajtimi dhe kujdesi infermieror” Durrës 2014.

### **3.14. Shenjat e hemoragjisë në traktin digjestiv të sipërm dhe të poshtëm**

#### **Shenjat e hemoragjisë në traktin e sipërm të tretjës**

- Gjak të kuq të ndritshme në të vjellat
- Të vjellat që duken si llum kafeje
- Feçe të zeza
- Gjak të errët të përzier me feçe
- Feçe të përzier ose të mbuluara me gjak të kuq të ndritshem.

#### **Shenjat e hemoragjis në traktin e poshtëm digjestiv përfshijnë:**

- Feçe të zeza
- Gjak të errët të përzier me feçe
- Feçe të përzier ose të mbuluar me gjak te kuq të ndritshem.<sup>19</sup>

---

<sup>19</sup> <http://www.centerforcolonandrectalsurgery.com/services-and-specialties/conditions/bleeding-of-the-digestive-tract>.

### **3.13. Shenjat e hemoragjisë akute dhe kronike**

#### **Cilat janë shenjat e hemoragjisë akute?**

- Dobësi e përgjithshme.
- Vështirësi në frymëmarrje
- Marramendje ,
- Dhimbje barku në formë krampesh.
- Ligështi, zbehje
- Diarre
  
- Vështersi në prodhimin e urines deri në shok.

#### **Cilat janë shenjat e hemorragjisë kronike?**

- Pa fuqi
- Lodhje
- Vështirësi në frymëmarrje
- Plogështi
- Ligështi,
  
- Anemi.<sup>20</sup>

---

<sup>20</sup> <http://www.altincekdhima.com/?go=hemoragjia>

### **3.15. Si dallohet hemoragjia në traktin digjestiv**

Shenjat e hemoragjisë së traktit digjestiv varen nga lokalizimi dhe ashpërsia e gjakderdhjes. Në qoftë se gjaku vjen nga zorra e trashë dhe rektumi, ai mund të jetë i pastër ose i përzier me materialet fekale. Materialet fekale mund të jenë të përziere me gjak të errët në qoftë se hemoragjia vjen nga pjesa e sipërme e zorrës së trashë apo prej zorrëve të holla. Kur ka hemoragji në ezofag, stomak apo duoden, materialet fekale zakonisht janë me ngjyrë të zezë. Materialet e vjella mund të jenë me përmbajtje gjaku të pastër ose në ngjyrë kafe. Në qoftë se hemoragjia është e fshehtë pacienti nuk mund ta dallojë ndryshimin e ngjyrës së feçeve. Kur ndodh papritur hemorragji masive, pacienti ndihet i dobët, ka marramendje, dobësi të përgjithshme, frymëmarrje të dobët, krampe abdominale ose diarre. Mund të ndodhë gjendje shoku me puls të shpejtuar, rënie të presionit të gjakut dhe vështirësi për të urinuar. Pacienti mund të bëhet shumë i zbehtë.

Kur hemoragjia është e pakët dhe ndodh për një periudhë të gjatë kohore, pacienti fillon të ndihet gradualisht i lodhur, letargjik (i plogështë), me vështirësi në frymëmarrje, dhe i zbehtë prej anemisë. Anemia është një situatë ku pakësohen rruazat e gjakut të pasura me hekur dhe hemoglobinë.

### **3.16. Si të dalloni gjakun në feçe dhe të vjellat?**

- Gjak i pastër që mbulon feçet .
- Gjak i errët i përziere me feçet.
- Feçe të zeza ose katran.
- Gjak i pastër në të vjella.
- Të vjella me përmbajtje gjaku në ngjyrë kafe.<sup>21</sup>

---

<sup>21</sup> <http://www.altincekdhima.com/?go=hemoragjia>



### 3.17. Qasja ndaj të sëmuarve me hemoragji nga trakti digjestiv

Kur dyshohet në hemoragji digjестive atëherë duhet analizuar:

Shenjat vitale, si: shtypja e gjakut, frekuenca e zemres dhe pulsi periferik, ngjyra e lëkures dhe e mukozave të dukshme, pikmente, gjendja e vetëdijes (shenjat e shokut), kurse nga ekzaminimet bëhet EKG, pasqyra e gjakut, koagulogram, grupi i gjakut, urea, glikemia, elektrolitet, bilirubina dhe transaminazat. Ekzaminimi digitorektal na ndihmon në përcaktimin e vendit të hemoragjis përmes ngjyrës se jashtëqitjes.

Qëllimi i parë terapeutik është stabilizimi hemodinamik i pacientit. Shpejtësia e dhëniës së infuzioneve kristaloide dhe koloide përcaktohet nga gjendja kardiopulmunare e pacientit. Me këtë se pari arrihet përmirësimi i shpejtë i qarkullimit të eritrociteve të mbetura dhe kompensimi i vëllimit të humbur. Të pacientet me mungesë oksigjenimi duhet të ipet oksigjen. Kontrollonhet edhe urinimi, i cili na tregon përgjigjen në reanimim. Në mbajtjen e stabilitetit hemodinamik ma mirë veprojnë përbërjet koloide (albumin, dekstrani) sepse mbeten në qarkullim më gjatë se sa preparatet kristaloide (tretjet fiziologjike, dextrose, glukosalina) etj.<sup>22</sup>

---

<sup>22</sup> Prof.Dr.Bozhidan Vrhovac “Mjekësi Interne – Gastroenterologjia”

### 3.18. Diagnostikimi

Vendi i hemoragjisë duhet të lokalizohet. Historia mjekësore dhe ekzaminimi i plotë fizik janë të rëndësishëm. Shenja të tilla si ndryshime në funksionin e zorrës, ndryshime të ngjyrës së materialeve fekale (të zezë apo katran), përbërja e tyre (e butë apo e fortë), dhe prania e dhimbjeve apo ndjeshmëria mund të ndihmojnë doktorin se cila pjesë e traktit tretës është e prekur.

Për shkak të marrjes së hekurit, bismuthit ose përdorimit të disa ushqimeve të cilat mund t'i japin ngjyrë të errët materialeve fekale të njëjtë me atë që i jep hemorragjia nga trakti tretës, doktori mund të testojë feçet tuaja për praninë e hemoragjisë me një analizë të quajtur feçe për gjak okult. Matja e parametrave të gjakut mund të tregojë nëse pacienti është anemik, duke ndihmuar doktorin të mendojë për ndonjë hemoragji të mundshme.<sup>23</sup>

#### *Anamneza*

Të dhënat anamnestike që mund të merren në pacientët me shenja të hemoragjisë në traktin digjektiv janë:

- Natyra dhe kohëzgjatja e hemoragjisë (kur ka filluar gjakderdhja dhe si është manifestuar ajo (hematemezë, melenë, hematokezi ).
- A është kjo gjakderdhja e parë apo është përsëritëse
- Nëse është e përsëritur cili ka qenë shkaktari i gjakderdhjes së mëparshme dhe si është ndaluar ajo (spontanisht, përmes endoskopit apo me rrugë kirurgjike).
- Nëse fjala është për sëmundje ulçeroze, çfarë terapie është përdorur dhe a është përdorur ajo me rregull.
- A vuan pacienti nga sëmundjet e zemrës, mushkërive, veshkave, diabeti apo sëmundjet malinje.

---

<sup>23</sup> <http://www.altincekodhima.com/?go=hemoragjia>

- A ka pasur operacione në zemër dhe në enët e gjakut
- A përdor i sëmurit NSAID ose antikoagulues dhe cilët. A është i sëmurit alkoolist.

***Ekzaminimi fizikal dhe hulumtimet laboratorike te gjakderdhja digjестive***

<b>Egzaminimi fizikal</b>	<b>Hulumtimet laboratorike</b>
Lëkura e zbehtë dhe e lagësht	RBC, Hgb, Hct (hematokriti nuk ndryshon në orët e para, meqë plazma dhe eritrocitet humbin në mënyrë të barabartë )
Frekuenca e pulsit	PLT, koha e protrombinës, koha parciale e tromboplastinës
Shtypja e gjakut	Grupi i gjakut dhe Rh faktori
Shenjat e sëmundjeve të mëlçisë	Urea dhe kreatinina
Ekzaminimi rektal (ngjyra e feçesit, hemoroidet etj.	Glikemia Enzimet e mëlçisë,EKG <sup>24</sup>

***Metodat diagnostike***

- ❖ **Endoskopia** është mënyra më e shpeshtë dhe më e sigurtë e diagnostikimit e cila lejon pamje direkte të vendit të hemoragjisë. Në shumë raste endoskopia përdoret njëkohësisht dhe si mënyrë trajtimi.

Endoskopi është një instrument fleksibël i cili mund të futet nga goja ose rektumi i pacientit, duke lejuar doktorin të vlerësojë ezofagun, stomakun, duodenin (***gastro-***

<sup>24</sup> Prof.Dr.Bozhidan Vrhovac “Mjekësi Interne – Gastroenterologjia”

*duodenoskopia*), zorrën e trashë (*kolonoskopia*), dhe rektumin (*sigmoidoskopia*).

Mënyra më e mirë për të diagnostikuar zorrët e holla është video-kapsula e cila gëlltitet nga pacienti. Kapsula ka një kamerë të vogël e cila transmeton imazhe në video monitor. Kjo metodë përdoret për të gjetur hemoragjitë në zonat e zorrës së hollë të cilat janë të vështira për tu parë me endoskopi konvencionale.

Ekzistojnë një sërë metodash të tjera për të lokalizuar burimin e gjakderdhjes.

- ❖ **Radiografia me barium**, në përgjithësi është më pak e saktë se sa endoskopia në lokalizimin e hemoragjisë. Ajo është e pavlefshme për të marrë biopsi dhe për ta trajtuar atë.
- ❖ **Skeneri** është i vlefshëm veçanërisht në rastet kur kemi sëmundje inflamatore apo kancer.
- ❖ **Angiografia** është një teknikë që përdor lëndë kontrast për të nxjerrë në pah enët e gjakut.

Kjo procedurë është shumë e përdorur në situatat kur pacienti ka hemoragji të madhe aq sa lënda kontrast rrjedh nga enët e gjakut dhe identifikon lokalizimin e gjakderdhjes. Në raste të veçanta angiografia lejon injektimin e një ilaçi nëpërmjet arteries për të ndaluar hemoragjinë.<sup>25</sup>

---

<sup>25</sup> <http://www.altincekodhima.com/?go=hemoragjia>

### 3.19. Trajtimi

Kur dyshojmë në hemoragji prej traktit tretës, duhet të bëjmë një vlerësim të shpejtë të të sëmurit. Masim shtypjen e gjakut, frekuencën e zemrës, pulsën periferik, përcaktojmë ngjyrën e lëkurës dhe mukozave të dukshme, zverdhjen, gjendjen e vetëdijes, ndërsa prej ekzaminimeve bëjmë EKG-në pasqyren e gjakut, koagulogramin, grupin e gjakut dhe Rh faktorin, urenë, glikeminë, elektrolitet, bilirubinën dhe transaminazat. Ekzaminimi digitorektal ndihmon në vlerësimin e vendit të gjakderdhjes.

Hapi i parë terapeutik është stabilizimi hemodinamik i të sëmurit. Vendoset kanila i.v me lumen të gjerë, e sipas nevojës vendosen edhe dy kanilla. Shpejtësia e infuzionit të tretjeve kristaloide dhe koloidale përcaktohet në bazë të statusit kardiopulmonar. Qëllimi i infuzionit është përmirësimi i shpejtë i qarkullimit të eritrociteve të mbetura dhe zëvendësimi i vëllimit të humbur. Përdorimi i oksigjenit bëhet tek të sëmurët me saturim të zvogëluar. Tek të sëmurët me sëmundje të mushkërive duhet bërë analizat gazore të gjakut arterial. Gjithashtu duhet të kontrollohet edhe sasia e urinës së eliminuar.

Tek të sëmurët me humbje të 10-20% të gjakut qarkullues nuk është i nevojshëm zëvendësimi i gjakut, mirëpo kjo realizohet përmes tretjeve fiziologjike. Tretjet koloidale (albuminat dekstrani etj) më gjatë mbahen në qarkullim sesa tretjet kristaloide (tretjet fiziologjike, dextrose etj), prandaj janë edhe më të mirë në mbajtjen e stabilitetit hemodinamik. Nëse bëhet fjalë për pacientë të dehidruar, atëherë tek ata krahas tretjeve koloidale jepen edhe tretje kristaloide.

Tek të sëmurët me gjakderdhje masive, më Hct më të vogël se 20% është e nevojshme të jepen tranfuzione të gjakut të plotë. Tek të sëmurët të cilët kanë humbur më shumë se 3 litra gjak, duhet t'u jepet gjak i ngrohur për të penguar hipoterminë.

Tranfuzioni i trombociteve indikohet te humbja e më shumë se 50% të vëllimit të gjakut.<sup>26</sup>

---

<sup>26</sup> Prof.Dr.Bozhidan Vrhovac “Mjekësi Interne – Gastroenterologjia”

**Endoskopia:** është primare në diagnostikim dhe procedurën terapeutike për shumë shkaqe të hemorragjisë gastro-intestinale.

Teknikat endoskopike nuk e ndalin gjithmonë hemorragjinë. Në disa raste angiografia është më efektive.

Gjithsesi kirurgjia është shpesh e nevojshme për të kontrolluar hemorragjitë aktive, të ashpra dhe të përsëritura, kur dështon endoskopia.<sup>27</sup>

---

<sup>27</sup> <http://www.altincekodhima.com/?go=hemoragjia>

### 3.20. Kujdesi infermieror

Roli i infermier-es/it në menaxhimin e një pacienti me një rrjedhje akute të sipërme të hemoragjis digjestive kërkon vëmendje të veçantë. Në radhë të parë, infermierja do të ketë një rol të veçantë në kujdesin infermieror që ndihmon një pacient më shok hipovolemik. Ngushëllimi i pacientit mund të mirëmbahet duke vlerësuar nevojën për analgjetik. Infermierja, e cila duhet të jetë e sigurtë në reanimim ( rrugët e frymëmarrjes, frymëmarrjen, dhe qarkullimin e gjakut), gjithashtu do të kërkohet të ndërmarrë vlerësimin e vazhdueshëm të gjendjes së lëngjeve dhe elektrolitve të pacientit.

Infermierët duhet të jenë të vetëdijshëm se hemoragjitë në traktin tretës shpesh mund të fshehin një problem tjetër, më pak të qartë. Prandaj, vlerësimi infermieror i pacientëve është i një rëndësie parësore. Është thelbësore që të fitoni sa më shumë informacion sa i përket problemeve shëndetësore të pacientit, përdorimit të ilaçeve dhe marrjes së alkoolit. Hemoragjit digjestive mund të lindin nga abuzimi me alkoolin ose keqpërdorimi i NSAID-it.

Vlerësimi fizik duhet të përqendrohet në peshën, gjendjen e lëkurës dhe humbjen e muskujve, dhe shenjat e tjera të sëmundjes së mëlçisë. Mirëqenia psikologjike duhet të shqyrtohet për të përcaktuar nëse një pacient është tepër i shqetësuar për shkak të pasigurisë së prognozës së tyre ose procedurave të shumëfishta të diagnostikimit dhe trajtimit që mund të kenë përjetuar. Pacientëve u duhet t'u jepet kohë e mjaftueshme për të diskutuar dhe shqyrtuar aspektet emocionale të sëmundjes së tyre. Infermieret duhet të përfshijnë në mënyrë aktive pacientët në edukimin sa i përket diagnozës, terapisë së drogës apo barnave dhe faktorëve që e shkaktojnë atë. Referimi i duhur i kujdesit parësor mund të kërkohet për të siguruar mbështetje adekuate.

**Hapi i parë** në ndërhyrjen infermiere është stabilizimi i rrugëve të frymëmarrjes, administrimi IV i lëngjeve ose të transfuzionit të gjakut.

Ruajtja e ekuilibrit hidro-elektrolik nëpërmjet likideve zëvendësuese për të rivendosur humbjet anormale të gjakut. Likidet zëvendësuese intravenoze janë vija e parë e trajtimit për hipovoleminë. Trajtimi fillestar me këto likide mund të sigurojë kontrollin e gjakderdhjes dhe të

arrijë të bëhet i mundur transfuzioni nëse ai është i nevojshëm. Të gjitha likidet koloide janë likide zëvendësuese solucionet koloide duhet të infuzohen në një volum të barabart me atë të gjakut deficitar.

**Hapi tjetër** bëhet monitorimi i vazhdueshëm i parametrave vital, presionit arterial, frekuences kardiak dhe frekuences respiratore.

Dhe shenjave si: takikardi, tahipne, oliguria, konfuzion ose lodhje, lëkurë të zbehtë, dhimbje koke, të ftohtë në duar dhe këmbë, disfagis etj.



## 4. Rekomandimet

### Parandalimi i gjakderdhjes gastrointestinale

Teknikat e parandalimit për gjakderdhje të sipërme dhe të poshtëme gastrointestinale bazohen në parandalimin e kushteve të lidhura. Ushqimi i një diete të shëndetshme, duke ushtruar lehtësisht dhe duke shmangur alkoolin dhe duhanin, mund të ndihmojë në nxitjen e një jetese të shëndetshme.

Pacienteve ju rekomandohet:

- Te pinë më shumë ujë
- Pacientave ju rekomandohet që të konsultohen me mjekun para se të fillojnë trajtimin me aspirina.
- Pas ngrënies, qëndroni të drejtë për të paktën një orë për të shmangur zbatcën e acidit.
- Nëse vihen re shenja të gjakderdhjes gastrointestinale, kërkoni menjëherë këshillë mjekësore.
  
- Pacienteve ju rekomandohet konsumimi i ushqimeve të pasura me fibra dhe përdorimi i laksative kur është e nevojshme stimulon lëvizshmërinë, e zorrëve, duke parandaluar konstipacionin i cili më pas mund të çojë në sëmundjen divertikulare dhe hemoroide.
- Më shumë vëmendje duhet t'i kushtohet drogës, sidomos barnave anti-inflamatore jo-steroidike të cilat, nëse merren për periudha të gjata dhe në disa raste pa mbrojtje stomakut, mund të shkaktojnë ulçera dhe gjakderdhje. Rreziku i një ulçere duodenale dhe gastrite është më i madhë nëse Helikobakter pylori është i pranishëm.

## 5. Përfundimi

Në bazë të rishikimit të literatures në këtë punim të temës së diplomes, kemi ardhur në përfundim se hemoragjia në traktin digjektiv, është një shenjë sëmundje dhe jo sëmundja vetë. Ku pra me hemoragji digjektivë nënkuptojmë çdo gjakderdhje në traktin digjektiv, shkaqet e hemoragjis digjektivë janë të shumta dhe mund të jenë lokale dhe të përgjithshme.

Në bazë të lokalizimit të hemoragjisë në traktin digjektiv kemi dalluar dy grupe të mëdha të hemoragjisë nga trakti digjektiv siq janë: Hemoragjia nga trakti i sipërm digjektiv dhe hemoragjia nga trakti i poshtëm. Ku është vënë re se hemoragjia në traktin digjektiv ndodhë më shpeshë në traktin e sipërm, sesa në traktin e poshtëm digjektiv. Ku ulçerat janë shkaqet më të zakonshme të shfaqjes së rasteve me hemoragji në pjesën e sipërme të traktit tretës. Kurse hemoroidet janë shkaqet më të zakonshme të shfaqjes së hemoragjisë nga pjesa e poshtëme e traktit digjektiv.

Hemoragjitë në traktin digjektiv pra rriten me rritjen e moshës kryesisht mbi moshën 60 vjeç dhe për gjininë mashkullore.

## 6. Referencat

- “Anatomia dhe fiziologjia e njeriut ”- Prof. Eshref Saraqini, Dr. Hariet Zherka - Saraqini.
- “ Mjekësi Interne – Gastroenterologjia ”- Prof. Dr. Bozhidan Vrerhovec.
- “ Parimet e Mjekësisë Interne Harrison ”- Anthony S.Fauci,MD , Eugene Braunëald,MD , Dannis L.Kasper,MD , Stephen L.Hauser, MD , Dan L.Longo,MD , J.Larry Jameson, MD,PHD , Joseph loscalzo, MD, PHD.
- “ Infermieristika në specialitete ”- E. Peka, L.Neqaj, E.Rustami, D.Bego, A.Imami-Lelqaj, M.Qela, A.Dervishi, V.Zanaj, V.Mane.
- Ivan Prpic “Kirurgjia“ për studentët e mjekësisë.
- <https://www.mayoclinic.org/diseases-conditions/gingivitis/symptoms-causes>
- <https://www.mayoclinic.org/diseases-condition/mouth-cancer/diagnosis-treatment/>
- <http://www.altincekdhima.com/?go=varice>
- <https://www.mayoclinic.org/diseases-conditions/esophagitis/diagnosis-treatment>
- <http://www.altincekdhima.com/?go=hemoragjia>
- <http://www.centerforcolonandrectalsurgery.com/services-and-specialties/conditions/bleeding-of-the-digestive-tract>.
- <http://mjeksiaislame.com/hemorroidet/>

## 7. CV-ja e kandidates

<b>Informata personale</b>	
Emri dhe Mbiemri	<b>Sevdije Idrizi</b>
Datëlindja	<b>08.12.1993</b>
Gjinia	<b>Femër</b>
<b>Të dhënat kontaktuese</b>	
Nr. Tel	<b>049 173 233</b>
Adresa	<b>Turiçec-Skënderaj</b>
Emaili	<b>Sev_dije17@outlook.com</b>
<b>Të dhënat e kualifikimit</b>	
Shkolla e Mesme e Lartë	<b>Shkolla e Mesme e Mjekësisë “Xheladin Deda” Mitrovicë Dega: Teknik i Farmacisë</b>
Universiteti	<b>Universiteti i Gjakovës "Fehmi Agani"</b>
Fakulteti	<b>Fakulteti i Mjekësisë</b>
Programi	<b>Infermieri</b>
Statusi	<b>E rregullt</b>
Nr.ID	<b>140306047</b>